



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



**Kuvendi i Komunës Rahovec**  
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec

RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/196 Nr. i faq./Br.str./No.pg 62

Data/Datum/Date 29.02.2024

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 53 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 10, paragrafi 2, pika 2.4, nenit 39, nenit 40 dhe nenit 57, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Shkresës së Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, me Nr. Prot. 31-1/2024, e datës 2.2.2024, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.02.2024, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për shfuqizimin e vendimit 01, Nr. 174/23, i datës 27.12.2023, për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2024**

1. Me këtë vendim, **shfuqizohet** vendimi me Nr. Prot. 01, Nr. 174/23, i datës 27.12.2023, për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2024.
2. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

*Vendimi u dërgohet:*

- MAPL-së,
- Kryetarit të Komunës,
- Shërbimit të Kuvendit, dhe
- Arkivit.

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

01Nr.196/24  
Datë:29.02.2024



**Arbër Zenuni**

**Kryesues i Kuvendit**